



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Informacion periodik i Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbi çështjet e regjistruara dhe vendimet

Kolegji i Posaçëm i Apelit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri në datën 31 dhjetor 2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur 296 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat 12 janë shpallur në vitin 2018, 34 janë shpallur gjatë vitit 2019, 42 gjatë vitit 2020, 38 vendime gjatë vitit 2021, 49 vendime gjatë vitit 2022, 55 janë shpallur gjatë vitit 2023 dhe 66 vendime gjatë vitit 2024 (*1 vendim rishikim vendimi i çështjes në themel*). Deri më 31 dhjetor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar 417 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, 40 gjatë vitit 2018, 62 gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021, 53 çështje gjatë vitit 2022, 57 çështje gjatë vitit 2023 dhe 56 çështje gjatë vitit 2024.

Sa i përket Juridiksionit Disiplinor, deri më 31 dhjetor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar 22 çështje të këtij Juridiksioni, nga të cilat 2 në vitin 2018, 1 në vitin 2019, 11 çështje gjatë vitit 2021, 2 çështje gjatë vitit 2022, 4 çështje gjatë vitit 2023 dhe 2 çështje deri gjatë vitit 2024.

Deri më 31 dhjetor 2024, janë marrë gjithsej 18 vendime të Juridiksionit Disiplinor, 9 vendime përfundimtare dhe 9 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare. Gjatë vitit 2018 janë shpallur 2 vendime: 1 vendim përfundimtar dhe 1 për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2020 është shpallur 1 vendim përfundimtar; gjatë vitit 2021 është shpallur 1 vendim përfundimtar dhe 3 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2022 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 4 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2023 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 1 vendim për moskalim të çështjes në seancë plenare. Gjatë vitit 2024 nuk është marrë asnjë vendim i Juridiksionit Disiplinor.

Deri në 31 dhjetor 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar në total për të dyja juridiksionet 439 çështje, 417 prej të cilave, çështje të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 22 çështje të Juridiksionit Disiplinor. Deri në 31 dhjetor 2024, në Kolegj janë marrë 314 vendime gjithsej për të dyja juridiksionet, 296 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 18 vendime të Juridiksionit Disiplinor. Deri në këtë datë, në Kolegj janë nën shqyrtim gjithsej 125 çështje, 121 prej të cilave të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 4 të atij Disiplinor.

Për informacion më të plotë, [klikoni këtu](#).